



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 921/ Prot.
2

Tiranë, më 30.03.2022

VENDIM

Nr. 23 , datë 30.03.2022

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VEPRIMTARINË MËSIMORE,
KËRKIMORE-SHKENCORE DHE FINANCIARE, PËR VITIN AKADEMIK 2020-
2021, TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të neneve 32, 36, 47, 49 (pika 1/h) e vijues të ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 4 të Udhëzimit Nr.5, datë 19.02.2018 i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) “Për përcaktimin e elementeve përbërës të Raportimit Vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019; të nenit 49 (pika 1), nenit 51 (pika 1/v) e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të Vendimit nr.4, datë 04.03.2022 të Rektoratit të UMT-së “Për miratimin e Raportit Vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare, për vitin akademik 2020-2021” të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30.03.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Raportin Vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare, për vitin akademik 2020-2021”, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
2. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ